



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:041107

Datë: 20.03.2024

Numri i dokumentit: 05477551

**Ac.nr.2815/2023**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Naime Ahmeti kryetare e kolegjit, Malsor Kryeziu dhe Rafet Haxhaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore paditëseve B.D.K., L.G.S., S.Q., E.D., dhe I.C., që të gjitha nga Prishtina, të cilat me autorizim i përfaqëson N.A., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson A.A., me objekt kontesti kompensimin e shpërblimit jubilar, duke vendosur sipas ankesës të së paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.851/2021, të datës 18.11.2022, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 20.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I.APROVOHET** pjesërisht si e bazuar ankesa e të paditurës Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.851/2021 i datës 18.11.2022, lidhur me kompensimin e shpërblimit jubilar për paditësen B.D.K., nga Prishtina, në pikën I (një) të dispozitivit, nënpika 1). **NDRYSHOHET** dhe gjykohet: **DETYROHET** e paditura Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK), që paditëses B.D.K., nga Prishtina, në emër të shpërblimit jubilar për njëzet (20) vite të përvojës së punës, t’ia kompensoj shumë prej 754.00 €, ndërsa po ashtu pika I (një) e dispozitivit, nënpika 2). Paditëses L.G.S., nga Prishtina, lidhur me kompensimin e shpërblimit jubilar, **NDRYSHOHET** dhe gjykohet: **REFUZOHET** kërkesëpadia e paditëses L.G.S., nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) me seli në Prishtinë, që në emër të shpërblimit jubilar për dhjetë (10) vite të përvojës së punës, t’ia kompensoj shumë prej 802.35 €, së bashku me normën e kamatës në lartësi prej 8%, nga data e hyrjes në fuqi e Kontratës Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë (12.06.2018), **SI E PABAZUAR.**

**II. REFUZOHET** pjesërisht si e pa bazuar ankesa e të paditurës Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.851/2021 i datës 18.11.2022, në pikën I (një) të dispozitivit në pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë me të cilën është detyruar e paditura Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) me seli në Prishtinë, në nënpikën **3**). Paditëses S.Q., nga Prishtina, në emër të shpërblimit jubilar për tridhjetë (30) vite të përvojës së punës, t'ia kompensoj shumën prej 1,131.00 €, në nënpikën **4**). Paditëses E.D., nga Prishtina, në emër të shpërblimit jubilar për dhjetë (10) vite të përvojës së punës, t'ia kompensoj shumën prej 377.00 €, dhe nënpika **5**). Paditëses I.C., që në emër të shpërblimit jubilar për njëzet (20) vite të përvojës së punës, t'ia kompensoj shumën prej 850.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës, **VËRTETOHEN**.

**III. NDRYSHOHET** kamata e gjykuar për paditëset B.D.K., S.Q., E.D., dhe I.C., dhe gjykohet: me kamatë prej 8% e cila do të llogaritet nga data e parashtrimit të padisë me datë 04.03.2021, e gjer në pagesën definitive.

## **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar ka vendosur si vijon:

*' I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëseve B.D.K., L.G.S., S.Q., E.D., si dhe I.C., që të gjithë nga Prishtina.*

*II. DETYROHET e paditura Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK), që paditësve, secilit veç e veç, t'ua paguaj shumat si në vijim:*

*1). Paditëses së parë B.D.K., në emër të shpërblimit jubilar për njëzet (20) vite të përvojës së punës, t'ia kompensoj shumën prej 802.35 €, së bashku me normën e kamatës në lartësi prej 8%, nga data e hyrjes në fuqi e Kontratës Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë (12.06.2018), e deri në pagesën definitive, në afat prej shtatë (7) ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit ligjor.*

*2). Paditëses së dytë L.G.S., në emër të shpërblimit jubilar për dhjetë (10) vite të përvojës së punës, t'ia kompensoj shumën prej 802.35 €, së bashku me normën e kamatës në lartësi prej 8%, nga data e hyrjes në fuqi e Kontratës Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë (12.06.2018), e deri në pagesën definitive, në afat prej shtatë (7) ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit ligjor.*

*3). Paditëses së tretë S.Q., në emër të shpërblimit jubilar për tridhjetë (30) vite të përvojës së punës, t'ia kompensoj shumën prej 1,131.00 €, së bashku me normën e kamatës në lartësi prej 8%, nga data e hyrjes në fuqi e Kontratës Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë (12.06.2018), e deri në pagesën definitive, në afat prej shtatë (7) ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit ligjor.*

*4). Paditëses së katërt E.D., në emër të shpërblimit jubilar për dhjetë (10) vite të përvojës së punës, t'ia kompensoj shumën prej 377.00 €, së bashku me normën e kamatës në lartësi prej 8%, nga data e hyrjes në fuqi e Kontratës Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë (12.06.2018), e deri në pagesën definitive, në afat prej shtatë (7) ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit ligjor.*

5). Paditëses së pestë I.C., në emër të shpërblimit jubilar për njëzet (20) vite të përvojës së punës, t'ia kompensoj shumën prej 850.00 €, së bashku me normën e kamatës në lartësi prej 8%, nga data e hyrjes në fuqi e Kontratës Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë (12.06.2018), e deri në pagesën definitive, në afat prej shtatë (7) ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

III. DETYROHET e paditura që në emër të shpenzimeve procedurale, t'ia kompensoj paditësit shumën në lartësi prej 737.60 €, në afat prej shtatë (7) ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit ligjor. Refuzohet pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëseve, përtej shumës se gjykuar dhe atë në emër të hartimit të precizimit të kërkesëpadisë në shumë prej 405.60 €, si e pa bazuar.''

Kundër këtij aktgjykimi i padituri në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit duke e aprovuar ankesën e të paditurës si të bazuar, ta ndryshoj aktgjykimin e atakuar dhe ta refuzoj si të pabazë kërkesëpadinë e paditëseve.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

*-Ankesa e të paditurës është pjesërisht e bazuar.*

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditëset, nëpërmes të autorizuarit, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK), me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që t'ua paguaj shumat lidhur me kompensimin e shpërblimit jubilar për 10, 20 dhe 30 vite të përvojës së punës duke përfshirë kamatën ligjore prej 8 % nga data e hyrjes në fuqi të Kontratës Sektoriale të Shëndetësisë, si dhe shpenzimet e procedurës. Padinë e ka mbështet bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë e nënshkruar me datë 11.06.2018 konform nenit 17, dhe nenit 4.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëseve, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqës si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëseve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsytim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se: në mes të palëve ndërgjyqës nuk ishte kontestues fakti se paditëset janë në marrëdhënie pune të e paditura dhe atë në bazë të kontratave të punës, ndërsa nga lista e pagave dhe vërtetimet për përvojën e punës të lëshuara nga e paditura është vërtetuar përvoja e punës të secilës nga paditëset. Kontestuese në mes palëve ndërgjyqës mbeten faktet nëse Kontrata Kolektive Sektoriale e dt.11.06.2018 prodhon efekt juridik për të paditurën, meqenëse nuk është nënshkruar nga ana e saj dhe nëse padia është parashtruar ashtu siç parashihet me nenin 90 par.4. të Ligjit të Punës. Detyrimi i të paditurës për pagesën e kamatës dhe kamatëvonesës prej 8% në vit është gjykuar nga gjykata konform nenit 382 të LMD-së. Ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e bazoi në nenin 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet edhe mënyrën se si janë vërtetuar faktet dhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, të cilat janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë. Nuk mund të pranohet pretendimi për këtë shkelje sepse ndryshimi i aktgjykimit ka të bëjë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale e jo me arsyetimin e gabuar. Zbatimi i gabuar i të drejtës materiale nga gjykata e shkallës së parë e ka përcaktuar edhe arsyetimin e aktgjykimit për kompensimin e pagave jubilarë në atë mënyrë që përfundimi meritor është arsyetuar në përputhje me dispozitat e LPK-së, pavarësisht se një përfundim të tillë të gjykatës së shkallës së parë, gjykata ankimore e ka ndryshuar në një pjesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në konstatimin e gabuar të gjendjes faktike, ngase gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike me provat e administruara, ngase nuk ka qenë kontestuese se paditësja B.D.K., është angazhuar me detyrat e punës infermiere në klinikën e kirurgjisë abdominale - laparaskopi, me shifër të pagës EM XXXXX kodin e punës H-XX, paga mujore 377 euro, paditësja L.G.S., është e angazhuar me detyrat e punës mjeke specialiste në klinikën e radiologjisë, paditësja S.Q., është e angazhuar me detyrat e punës infermiere në QKUK, paditësja E.D., është e angazhuar në detyrat e punës mami në KOGJ, me shifër të pagës EMXXXXX, kodi i punës H-XX, paga mujore 377 euro, si dhe paditësja I.C., është e angazhuar në detyrat e punës instrumentare në Klinikën e Kirurgjisë Plastike, me shifër të pagës EMXXXX, kodin e punës H-XX, paga mujore 425 euro.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin shpenzimeve të ushqimit ditor drejtë ka zbatuar të drejtën materiale dhe me të drejtë është bazuar në dispozitën e nenit 17 paragrafi 3 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, të datës 12.06.2018, është e paraparë se: *“Punëtorët shëndetësor në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i tyre i fundit në vlerë: 3.1.për 10 vjet të përvojës së punës në institucione shëndetësore, në vlerë të një page mujore të tij, 3.2. për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij, dhe 3.3.për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij”*. Ndërsa në paragrafin 4 të Kontratës Kolektive Sektoriale parashihet se: *“Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë, Shpërblimi jubilar paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”*.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore e duke u bazuar në këtë gjendje faktike Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejt ka aplikuar të drejtën materiale përkitazi me aprovimin e kërkesëpadisë së paditëseve B.D.K., S.Q., E.D., dhe I.C., për

kompensimin e shpërblimit jubilar, duke qenë nga vërtetimet e përvojës së punës të lëshuara nga e paditura, është vërtetuar se paditësja B.D.K., është në marrëdhënie pune te e paditura që nga viti 1999, ndërsa jubileun e 20 e ka arritur në vitin 2019, paditësja S.Q., që nga viti 1985, ndërsa jubileun e 30 e ka arritur në vitin 2015, paditësja E.D., që nga viti 2009, ndërsa jubileun e 10 e ka arritur në vitin 2019 dhe paditësja I.C., që nga viti 1999, ndërsa jubileun e 20 e ka arritur në vitin 2019, andaj gjykata e shkallës së parë, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së këtyre paditëseve, duke e detyruar të paditurën që në emër të përvojës së punës së tyre, paditëseve t'ua paguaj shumat si në dispozitiv të aktgjykimit ankimor në emër të shpërblimit jubilar, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale të nënshkruar nga Qeveria - Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi nga data 12.06.2018 dhe e njëjta është e zbatueshme, e cila është në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 Ligjit të Punës.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është nxjerr me vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes së fakteve dhe aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje të dispozitave të karakterit procedural të rëndësisë esenciale, të cilat e bëjnë që çështja të rivlerësohet nga aspekti i themelit sërish në shkallë të parë me rishqyrtim, por ka gjetur se mbi gjendjen faktike të vërtetuar drejtë, plotësisht gabimisht është zbatuar e drejta materiale, gjegjësisht dispozita e nenit 17 paragrafi 3 pika 3.1 dhe 3.3 Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë e cila ka hy në fuqi me datë 12.06.20218, me rastin e detyrimit të të paditurës që paditëses L.G.S., për 10 vite përvojë pune te e paditura, në emër të shpërblimit jubilar, t'ia kompensoj shumën e gjykuar si në dispozitiv të aktgjykimit ankimor, andaj kolegji i kësaj gjykate ka gjetur se aktgjykimi i atakuar duhet të ndryshohet në mënyrë që i njëjti të përlligjet me zbatimin e drejtë të së drejtës materiale mbështetur në gjendjen e fakteve dhe provave që përbëjnë themelësinë faktike të çështjes.

Kjo dispozitë përcakton të drejtën e punëtorit për shpërblim jubilar, mirëpo në rastin konkret themelësia e kësaj pjese të kërkesëpadisë nuk ka mundur të mbështetet në dispozitën e nenit 17 paragrafi 3 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, të datës 12.06.2018, për shkak se kjo kontratë për paditësen L.G.S., nuk ka prodhuar efekt juridik dhe këtë prapësim e ka paraqitur e paditura me rastin e dhënies së përgjigjes në padi.

Me dispozitën e nenit 17 paragrafi 3 pika 3.1 dhe 3.3 Kontratës Kolektive Sektoriale, të nënshkruar nga Qeveria - Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi nga data 11.06.2018, sipas nenit 36 të saj, e njëjta ka hyrë në fuqi me momentin e nënshkrimit nga palët nënshkrues dhe nuk ka paraparë dispozita retroaktive, për faktin se për paditësja L.G.S., nga vërtetimi i dt.24.12.2019 është vërtetuar se është në marrëdhënie pune nga data 03.05.2003, ndërsa jubileun e 10 e ka arritur në vitin 2013, kështu që e drejta e paraqitjes të kërkesës për shpërblim jubilar të paditëses në këtë rast, ka filluar nga data e hyrjes në fuqi të MPKK-së, datë 01.01.2015 dhe afati i fundit për paraqitjen e kërkesës ka qenë data 31.12.2017, ndaj në këtë rast rezulton se viti jubilar i saj ka qenë vitin 2013, atëherë kur nuk ka pasur bazë ligjore për shpërblim jubilar.

Paditësja L.G.S., padinë e ka paraqitur me datë 04.03.2021, dhe në këtë rast nuk mund të aplikoheshin dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë të datë 12.06.2018, ndaj dhe në situatën e tillë është dashur që kërkesa të refuzohet në tërësi si e pabazuar, për shkak se e drejta subjektive e pretenduar me padinë e saj nuk ka gëzuar mbrojtje juridike, për faktin se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015.

Gjykata e Apelit, mori parasysh pretendimin ankimor të të paditurës lidhur me faktin se Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë nuk është obligative për të paditurën, meqenëse nënshkruarit e kësaj kontrate siç janë Ministria e Shëndetësisë dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, nuk janë angazhuar asnjëherë për zbatimin e dispozitave që kanë implikime financiare. Lidhur me këto pretendime, Gjykata e Apelit vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive Sektoriale, rrjedh se obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, i takojnë pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë e paditura. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditëseve, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë.

Lidhur me pjesën e ndryshuar të aktgjykimit të atakuar sa i përket shumës së aprovuar për paditësen B.D.K., në emër të shpërblimit jubilar për njëzet (20) vite të përvojës së punës, Kolegji i kësaj gjykate ka vendosur që ta ndryshoj shumën e gjykuar si në dispozitiv të aktgjykimit ankimor duke u bazuar në vërtetimin e dt.05.11.2020, nga i cili vërtetohet kodi i punës H-XX, me pagë mujore 377 €, si dhe në parashtrësën e precizuar nga i autorizuari i saj të datës 14.11.2022, ku për këtë paditëse kërkesën e ka precizuar në shumë prej  $377 \times 2 = 754.00$  €, ndërsa që gjykata e shkallës së parë duke e aprovuar shumën si në dispozitiv të aktgjykimit ankimor ka bërë tejkalim të kërkesëpadisë së paditëses, mbi këtë bazë është bërë ky ndryshim. Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e të drejtës materiale, e ka bërë ndryshimin e aktgjykimit ankimor, lidhur me kamatën e gjykuar, meqenëse është zbatuar gabimisht e drejta materiale, në këtë rast është zbatuar në mënyrë të gabuar dispozita e nenit 382 par.1 dhe 2 i LMD-së, pasi që kamata nuk është përcaktuar në përputhshmëri edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës Agj.nr.265/2020 të datës 02.12.2020, pjesa e dytë, paragrafi VI, lidhur me paragrafin XIV, me të cilin është përcaktuar se: *kamata fillon të rrjedhë nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën e plotë.*

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Andaj, për arsyet e dhëna si më sipër e mbështetur në nenin 194, 195 par.1 pika d) dhe e) lidhur me nenin 201 par.1 pika d) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.2815/2023, me datë 20.03.2024**

**Kryetarja e Kolegjit,**  
**Naime Ahmeti, d.v.**